

UDHËZUES PËR PARAQITJEN E ANKESAVE NDAJ GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Ky udhëzues është përgatitur nga **Lëvizja FOL** për të lehtësuar procedurën e paraqitjes së ankesave për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Udhëzuesi është bazuar në Ligjin nr. 06/l-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Ligjin nr. 08/l – 003 për ndryshmin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/l-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Rregulloren (05/2019) për procedurën disiplinore të gjyqtarëve, si dhe Rregulloren (05/2019) për procedurën disiplinore të prokurorëve.

- Të gjithë personat fizik dhe juridik mund të paraqesin ankesa për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve tek Autoritetet Kompetente.
- Gjyqtarët dhe prokurorët kryejnë shkelje disiplinore kur:
 - Dënohen për ndonjë vepër penale;
 - Shkelin ligjin;
 - Shkelin detyrat e tyre si gjyqtar/e prokuror/e.

● **Autoritete Kompetente janë:**

KRYETARËT E GJYKATAVE THEMELORE

(për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse);

KRYETARI/JA I/E GJYKATËS SË APELIT

(për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit);

KRYETARI/JA I/E GJYKATËS SUPREME

(për shkeljet disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe të Kryetarit të Gjykatës së Apelit);

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

(për shkeljet disiplinore të Kryetarit të Gjykatës Supreme);

KRYETARËT E PROKURORIVE THEMELORE

(për shkeljet disiplinore të prokurorëve të prokurorive përkatëse);

KRYEPROKURORI I SHTETIT

(për shkeljet disiplinore të Kryeprokurorëve të prokurorive) dhe

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

(për shkeljet disiplinore të Kryeprokurorit të Shtetit).

- Ankesat për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve mund të dërgohen edhe tek Avokati i Popullit.
- Nëse ankesa i dërgohet autoritetit jo kompetent, autoriteti i tillë duhet t'a transferoj ankesën tek autoriteti kompetent. Pas pranimit të ankesës, Autoriteti Kompetent e shqyrton atë në afat prej 30 ditësh, dhe pas shqyrtimit autoriteti mund t'a hedh poshtë ankesën, t'a refuzoj, ose të kërkoj fillimin e hetimeve (me ç'rast krijohen Panelet Hetimore në këshillat përkatës).
- Panelet Hetimore të këshillave përkatës zhvillojnë hetimet brenda 3 muajve nga dita e themelimit. Nëse ka rrethana të jashtëzakonshme dhe në bazë të kërkesës, këshilli mund të zgjas hetimet edhe për 2 muaj.
- Pas 15 ditësh prej përfundimit të hetimeve, paneli i dërgon raport këshillit përkatës. Pas 30 ditësh prej ditës së dërgimit të raportit, këshilli përkatës e cakton seancën dëgjimore dhe e merr vendimin.
- Sanksionet disiplinore që mund të shqiptojnë këshillat përkatës ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve janë:
 - Vërejtje jopublike me shkrim;
 - Vërejtje publike me shkrim;
 - Zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në pesëdhjetë përqind (50%) për një periudhë deri në 1 vit;
 - Transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë ose prokurori tjetër të nivelit më të ulët;
 - Propozim për shkarkim.
- Pala e pakënaqur me vendimin mund të paraqes ankesë në Gjykatën Supreme në afat prej 15 ditësh prej pranimit të vendimit.

Ankesat për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të përpilohen me shkrim, duke plotësuar formularin e mëposhtëm, përdorimi i të cilës nuk është obligativ për paraqitjen e ankesave.

Ankesa duhet të dërgohet në adresën zyrtare të autoritetit kompetent (e cila gjendet e publikuar në ueb-faqen zyrtare të institucionit), duke i bashkangjitur edhe dokumentet relevante në lidhje me shkeljen e pretenduar.



Ky formular është përgatitur nga Lëvizja FOL për ta lehtësuar procedurën e paraqitjes së ankesave për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pra, ky formular nuk është zyrtar dhe përdorimi i tij nuk është obligativ për paraqitjen e ankesave për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Formulari është përgatitur bazuar në Ligjin nr. 06/l-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Ligjin nr. 08/l – 003 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/l-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Rregulloren (05/2019) për procedurën disiplinore të gjyqtarëve, si dhe Rregulloren (05/2019) për procedurën disiplinore të prokurorëve

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, parashtroj këtë:

ANKESË

pranë Autoritetit Kompetent për shkelje disiplinore të gjyqtarit/prokurorit

I. TË DHËNAT PERSONALE TË ANKUESIT

Emri dhe mbiemri i ankuesit (apo përfaqësuesit): _____

Emri i personit juridik dhe selia (apo përfaqësuesit): _____

Shtetësia: _____

Adresa e përhershme: _____

Adresa elektronike dhe kontakt telefoni: _____

II. SUBJEKTI NDAJ TË CILIT DREJTOHET ANKESA

Gjyqtar /e

Prokuror/e

Emri dhe mbiemri: _____

Gjykata/Prokuroria ku subjekti ushtron ose ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar: _____

III. INFORMACIONE NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN PËR TË CILËN PARAQITET ANKESA

Numri i lëndës dhe data: _____

Lloji i çështjes: _____

Përfshirja e ankuesit në çështjen e lartpërmendur: _____

Faza aktuale e procedurës: _____

A jeni ankuar për të njëjtat fakte më parë? (Nëse Po, specifikoj numrin e regjistrimit të ankesës):

IV. SHKELJA DISIPLINORE E PRETENDUAR

Cila është ankesa juaj?

V. TË DHËNA MBI DËSHMITARË TË RASTIT APO PROVAT MBI TË CILËN BAZOHET ANKESA

Emri dhe mbiemri i dëshmitarit/es: _____.

Adresa e përhershme: _____.

Adresa elektronike: _____.

Numri i telefonit: _____.

Prova: _____.

KONFIDENCIALITETI

Të dhënat e ofruara konsiderohen konfidenciale dhe do të përdoren nga autoriteti kompetent vetëm për qëllime të hetimit.

SHËNIM: Nëse pjesë të caktuara të formularit janë të pamjaftueshme për deklaram të të dhënave, mund të shtoni pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin të gjitha të dhënave.

DATA DHE VENDI:

NËNSHKRIMI:
